

Ankimet e subjekteve për tenderin e datës 18/12/2017

Ankimi nr. 1

Ankim i subjektit: Noa Energy Trade

Përshëndetje,

Ju bëjmë me dije se, në lidhje me procedurën e zhvilluar sot (18.12.2017) nga OST sh.a, Tenderi për Blerjen e Energjisë Elektrike me Bazë Vjetore për Humbjet në Rrjetin e Transmetimit, hasëm problem teknike në platformën DAMAS të OST, gjatë momentit të ofertimit.

Gjatë dhënies së ofertave, cdo faqe hapej shumë shpejt, përveç fazës së fundit, kur duheshin futur bids (ofertat). Që në ofertën e parë të dhënë nga ne në orën 11:33, u vu re ngadalësim I pranimit të parametrave të ofertës dhe në ofertat e mëpasshme (psh. Për periudhën 25 mars) sistemi na nxirrte jashtë nga platforma, dokumentuar në screenshot bashkëlidhur.

Teksa hasëm këtë vështirësi, ju vumë menjëherë në dijeni për pamundësinë për të ofertuar në platform gjatë periudhës kohore të ofertimit. Staffi juaj dhe pse u përpoq të na asistonte brenda të gjitha mundësive të lejuara nuk arritëm të ofertonim brenda afateve të specifikuara.

Theksojmë që problematika ka qënë e platformës DAMAS, pasi në zyrën tonë kishim suportin e IT-së, I cili konstatoi se internet ishte cilësor dhe nuk ishte shkak I bllokimit të ofertimit në platformë, pasi funksiononte normal dhe me shpejtësi maksimale në site të tjera. Pas shqyrtimit të mesazhit të dërguar në mënyrë automatike nga platforma (bashkëngjitur kësaj shkrese), u konstatua se shkak I kësaj mos plotësimi performance ka qënë një gabim “error” nga CLR, ‘Common Language Run Time’, e versionit .NET në anën e serverit me të cilin punon platforma DAMAS.

Për këto arsye, bazuar në Vendimin e ERE, Nr. 103, datë 23.06.2016 “Për miratimin e Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e Humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik” neni 18, “Procedura administrative e ankimit”, ne bëjmë kërkesën për të ripërsëritur procedure e tenderimit duke na krijuar dhe mundësinë për të ofertuar si shoqëritë e tjera tregtare.

Duke ju falenderuar dhe kërkuar mirëkuptim, jemi në pritje të një përgjigje nga ana juaj.

Përgjigja e OST. SHA mbi ankimin:

Ne lidhje me ankimin tuaj zyrtar lidhur me problemet teknike të hasura në Platformën DAMAS të OST sh.a, gjatë momentit të ofertit, duam tju bejme me dije se ky ankim u mor ne shqyrtim nga OST sh.a, pas të cilit rezultoi se:

Subjekti “Noa Trade sh.p.k”, në Procedurën e Prokurimit për blerjen e energjisë së Humbjeve në rrjetin e Transmetimit, të zhvilluar në datë 18/12/2017, ka paraqitur oferta nëpërmjet platformës elektronike DAMAS.

Nga ofertat e këtij subjekti, asnjë nuk ishte në formën e kërkuar nga OST sh.a, lidhur me sasinë e përcaktuar në kalendarin e ofertave, duke qënë se ofertat nuk kanë përmbushur kriterin e ofertës vjetore.

Në bazë të Vendimit nr. 103, datë 23.06.2016, nëpërmjet Kalendarit te Ofertave, u përcaktua nga OST sh.a, periudha e prokurimit e cila ishte me bazë vjetore. Gjithashtu dhe në emailin sqarues të datës 16/12/2017, ju është bere me dije fakti se ofertat e paraqitura duhet të jenë vjetore, në të kundert do të quhen si oferta të pavlefshme nga ana e OST.

Në këto kushte, duke u bazuar në Vendimin nr. 103, i cili përcakton se “Blerësi duhet të vlerësojë ofertat e ardhura në mënyrë automatike me kohën e hapjes/mbylljes bazuar vetëm në cmimin për MWh”, si dhe në faktin që nuk mund të ketë oferta në vlerë 0 (zero) lekë për MWh, ofertat e subjektit “Future Energy Trade” sh.p.k, janë skualifikuar.

Sqarojmë se ky qëndrim është mbajtur në të gjitha rastet e ngjashme, për të gjitha subjektet ofertuese.

Lidhur me ankimin tuaj mbi mosfunksionimin e platformës elektronike, ju bëjmë me dije se pavarësisht faktit se subjekti “Noa Energy Trade” sh.p.k, ka ofertuar në platformën elektronike DAMAS duke e çuar procesin deri në fund pa probleme, pas ankimit tuaj, OST sh.a, kreu inspektimet perkatase mbi Platformen DAMAS dhe funksionimin e saj dhe rezultoi se nuk ishte problem në sistem, por ishte problem në mënyrën e përdorimit të sistemit.

Problemi I hasur është si vijon: Kur tregtari ne WEBFORM fillimisht zgjedh “Edit by Interval” dhe klikon në Show Data- shfaqet formulari , me pas tregtari ka klikuar “Edit by day” duke ndryshuar parametrin por pa rifreskuar forme duke klikuar Show Data perseri. Pa rifreskuar tregtari përpiqet dergoje ofertën dhe ktu sistemi shfaq një gabim.

Pra në këto kushte, nuk jemi ne rastet e mosfunksionimit te platformes por të operimit jo te drejtë të platformës nga ana e tregtareve gjate vendosjes se ofertave. Gjithashtu në këtë kuadër, duam të theksojme faktin se subjekte të tjerë, e kanë përfunduar procesin brenda afateve të përcaktuara duke dhënë dhe ofertë konform kërkesave të përcaktuara ne kalendarin e ofertave.

Në përfundim, ju bëjme me dije se Procedura e Prokurimit e sipërcituar do të përsëritet në zbatim të nenit 15, të Vendimit nr. 103, datë 23.05.2016, duke qënë se numri ofertuesve ka qënë më i ulët se tre.

Ankimi nr. 2

Ankimi subjektit “Future Energy Trade”:

Ankese lidhur me rezultattet e tenderit te dates 18.12.2017 per prokurimin e humbjeve

E nderuar Znj. Merkaj,

Ne vijim te korrespondneces se djeshme me email, dhe ankesave tona te vazhdueshme lidhur me mosfunksionimin e sistemit te prokurimit ANS ne platformen e Damas, deshirojme qe me ane te kesaj shkrese te parashtrojme ankesen dhe verjetjet tona si ne vazhdim

1.Rezultatet e tenderit dueht te konsiderohen asimetrike per sa kohe qe operatoreve te interesuar per dhenien e ofertes se tyre, nuk ju eshte vene ne dispozicion nje platformelektronike funksionale. Ky perfndimi I yni mbeshtetet ne argumenetet e meposhtme.

a)Edhe pse ne dukje plartforma e DAMAS gjate periudhe se testimi ditën e enjte dhe te premtë javen e kaluar duikej funksionale, gjate dites se djeshme ne kemi hasur shume veshtiresi ne operimin e saj.

b)Veshtiresite lidhen me faktin se tenderi presopozohej t eishte tender vjetor dhe Itille duhet ti lejonte operatoreve futjen e te dhenave me baze intervalin kohor nga dt 01.01.2018-31.12.2018. Duke patur parasysh korrespondencat bashkengjitur me email, kjo nuk ishte e mundur te aplikohet ne system.

c)Pasi ndoqem udhezimet tuaja per te vecuar datat 25 Mars dhe 28 Tetor si data me orar me shkurter ose me te gjate se 24 ore, perseri platform nuk lejonte dhenien e ofertes per te gjite perudhen kohore.

d)Ne kemi testuar te japim oferten me baze mujore dhe kjo po ashtu nuk mundesohej nga sistemi. Problemet e lidhura me dhenien e ofertes ne baza mujore e kemi shprehur edhe ne email e dates se djeshme, ku faqja e OST ne te cilen eshte ndertuar platform nuk pergjigjej.

e) Pas ketyre perpjekejve jemi detyruar ta ndajme periudhen kohore ne disa pjese duke e kufizuar ate ne 3 pjese kryesore (te detyrueshme per shkak te 25 Mars dhe 28 Tetor) Ne kemi beret e mudnur qe te hedhim te dhenat

brenda periudhes kohore te mbetur ne dispozicion, por kemi marre nje "system error", I cili ju eshte derguar edhe me email dje.

Duke patur parasysh keto probleme te platforms elektronike kerkojme anullimin e rezultateve te tenderimit dhe rishpalljen e tij ne nje kohe te pershtatshme kur platforma elektronike te mundesoje qasje me "user friendly" duke na dhene mundesine te gjithë operatoreve te veme ne dispozicion te vleresimit nga ana e OST te ofertave tona me te mira.

Duke ju falenderuar parapraksht per bashkepunimin dhe duke shpresuar ne mirekuptimin tuaj, bashkengitur kesaj letre mund te gjeni edhe korrespodnencen e djeshme me ane te email.

Pergjigja e OST sh.a, subjektit:

Ne lidhje me ankimin tuaj zyrtar lidhur me mosfunksionimin e platformes elektronike, duam tju bejme me dije se ky ankim u mor ne shqyrtim nga OST sh.a, pas të cilit rezultoi se:

Subjekti "Future Energy Trade" sh.p.k, në Procedurën e Prokurimit për blerjen e energjisë së Humbjeve në rrjetin e Transmetimit, të zhvilluar në datë 18/12/2017, ka paraqitur oferta nëpërmjet platformës elektronike DAMAS.

Nga ofertat e këtij subjekti, asnjë nuk ishte në formen e kërkuar nga OST sh.a, lidhur me sasinë e përcaktuar në kalendarin e ofertave, duke qënë se ofertat nuk kanë përmbushur kriterin e ofertës vjetore.

Siç jeni njoftuar nëpërmjet Kalendarit të Ofertave, përcaktohej periudha e prokurimit e cila ishte me bazë vjetore. Gjithashtu dhe në emailin sqarues të datës 16/12/2017, ju është bere me dije fakti se ofertat e paraqitura duhet të jenë vjetore, në të kundert do të quhen si oferta të pavlefshme nga ana e OST. Në këto kushte, duke u bazuar në Vendimin nr. 103, i cili përcakton se "Blerësi duhet të vlerësojë ofertat e ardhura në mënyrë automatike me kohën e hapjes/mbylljes bazuar vetëm në cmimin për MWh", si dhe në faktin që nuk mund të ketë oferta në vlerë 0 (zero) lekë për MWh, ofertat e subjektit "Future Energy Trade" sh.p.k, janë skualifikuar. Sqarojmë se ky qëndrim është mbajtur në të gjitha rastet e ngjashme, për të gjitha subjektet ofertuese.

Lidhur me ankimin tuaj mbi mosfunksionimin e platformës elektronike, ju bëjmë me dije se pavarësisht faktit se subjekti "Future Energy Trade" sh.p.k, ka ofertuar në platformën elektronike DAMAS duke e çuar procesin deri në fund pa probleme, pas ankimit tuaj, OST sh.a, kreu inspektimet perkatase mbi Platformen DAMAS dhe funksionimin e saj dhe rezultoi se nuk ishte problem në sistem, por ishte problem në mënyrën e përdorimit të sistemit.

Problemi i hasur është si vijon: Kur tregtari ne WEBFORM fillimisht zgjedh "Edit by Interval" dhe klikon në Show Data- shfaqet formulari , me pas tregtari ka klikuar "Edit by day" duke ndryshuar parametrin por pa rifreskuar forme duke klikuar Show Data perseri. Pa rifreskuar tregtari përpiqet dergoje ofertën dhe ktu sistemi shfaq një gabim.

Pra në këto kushte, nuk jemi ne rastet e mosfunksionimit te platformes por të operimit jo te drejtë të platformës nga ana e tregtareve gjate vendosjes se ofertave. Gjithashtu në këtë kuadër, duam të theksojme faktin se subjekte të tjerë, e kanë përfunduar procesin brenda afateve të përcaktuara duke dhënë dhe ofertë konform kërkesave të përcaktuara ne kalendarin e ofertave.

Në përfundim, ju bëjmë me dije se Procedura e Prokurimit e sipërcituar do të përsëritet në zbatim të nenit 15, të Vendimit nr. 103, datë 23.05.2016, duke qënë se numri ofertuesve ka qënë më i ulët se tre.

Të gjitha informacionet për datat e përsëritjes së tenderit si dhe informacionet e tjera, mund ti gjeni në faqen zyrtare të www.ost.al.

Ju faleminderit!